



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Alko Impex” Sh.P.K. të datës 21.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 16.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore” me nr. të prokurimit 616-23-14005-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Alko Impex” Sh.P.K. e datës 21.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 16.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore” me nr. të prokurimit 616-23-14005-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Alko Impex” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Alko Impex” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 21.02.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 16.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore” me nr. të prokurimit 616-23-14005-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraparak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore janë si në vijim: "Deshmia e cila mungon: Per piken a,b,c te dorezohem certifikatat sipas kerkeses te cilat duhet te jene te noterizuara nga Orgjinali nga vete bartesi i certifikates pas dates se publikimit te njoftimit per kontrate te ketij projekti. Arsyetim/Fakte: Kerkesat per piken a,b,c jane: 1.Inxhinier I dip. I ndertimtarise drejtimi konstruktiv Ing. Xhavit Ratkoceri 2.Inxhinier I dip. I arkitektures Ing.Rabit Halili 3.Inxhinier i dip. i ndertimtarise drejtimi infrastructure rrugore Ing.Nuhi Nuhiu Asnje nga inxhinierat te kerkuar nga pika a, b dhe c, nuk e kane certifikaten sipas kerkeses dmth nuk jane te certifikuar per shendet dhe siguri ne pune".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se ato i referohen kërkesave teknike dhe profesionale të dosjes së tenderit. Mirëpo te pjesa e kërkesës për rishqyrtim deklarata e detajuar e fakteve dhe argumenteve nuk është sqaruar se kundër kujna janë drejtuar këto pretendime ankimore. Nën supozimin se këto pretendime ankimore janë drejtuar kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë, vlen të thuhet se nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional janë përmbushur në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.02.2024

Visar SHEHU  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.